



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH. II.nr.1473/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit A.R shtetas nga Zvicra të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve K... nga Prishtina ndaj kundërshtarit të sigurimit A.K nga Peja të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B avokat nga Peja, dhe kundërshtares së sigurimit E.K nga Peja, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërpropozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.E.K.nr.868/21 datës 21.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.09.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërpropozuesit të sigurimit A.K nga Peja, dhe VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.E.K.nr.868/21 e datës 21.04.2022.

### A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar I.E.K.nr.868/21 datës 21.04.2022, e ka Miratuar si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit, ashtu që detyrohen kundërshtarët e sigurimit A.K aksionar dhe drejtor menaxhues në Shoqërin Tregtare Orenda shpk dhe E.K -person i autorizuar në Shoqërin Tregtare, që propozuesit të sigurimit ti lejojnë qasje në të gjitha dokumentet dhe arkivat e Shoqëris Tregtare Orenda shpk, duke përfshirë bilancet, deklaratimet në ATK, librat financiar, dokumentet e arkivuara që kanë të bëjnë me pasqyrat e shpenzimeve të biznesit, dëshmit e investimeve, librat ndërtimor, kontratat me palët e treta, dëshmit e punëve të përfunduara, e dokumentet tjera të Shoqëris Tregtare.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i kundërshtarit të sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i atakuar të priset ose qështja të kthehet në rigjykim. Në parim nuk e kemi kundërshtuar propozimin për caktimin e masës sepse që nga data 08.03.2020 të paditurit i është mohuar e dreja që të ketë qasje në Shoqërin Tregtare në fjalë, dhe s,ka pasur nevojë për caktimin e masës, por tani kundërshtohet me ankes detyrimi lidhur ma afatshmërin prej 7 ditësh per dorzim të shkresave, kur nuk dihet per cilën periudhë kohore është detyruar i padituri të bëj dorzimin e shkresave sipas aktvendimit. Gjykata ka bërë vërtetim te gabuar të gjendjes faktike duke e detyruar të paditurin që ti lejojnë qasje në dokumente në afat prej 7 ditësh. Gjykata e shkallës së parë nuk specifikon se për cilën periudhë kohore e detyron të paditurin që të ofroj qasje në bilancë, deklarime në ATK,

libra ndërtimor, kontrata me palët e treta, andaj konsiderojm se gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

I autorizuari i propozuesit të sigurimit në përgjigje në ankesë deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet në ankesë për shkak se gjykata e ka arsytuar në mënyrë të plotë mënyrën e vendosjes dhe më këtë rast nuk është shkelur asnjë dispozitë e vetme e LPK-së. I propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e kundërpropozuesit ndërsa aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj në tërsi.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i sigurimit A.R shtetas nga Zvicra, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 30.12.2021, ka paraqit padi me propozimin e masës së sigurimit kundër të paditurave-kundërshtarëve të sigurimit A.K nga Peja të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B avokat nga Peja, dhe kundërshtares së sigurimit E.K nga Peja

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin e masës së sigurimit, ka marrë Aktvendimin I.EK.nr.868/21 datës 21.04.2022, me të cilin e ka Miratuar si të pabazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit, ashtu që detyrohen kundërshtarët e sigurimit A.K aksionar dhe drejtor menaxhues në Shoqërinë Tregtare Orenda shpk dhe E.K-person i autorizuar në Shoqërinë Tregtare, që propozuesit të sigurimit ti lejojnë qasje në të gjitha dokumentet dhe arkivat e Shoqërisë Tregtare Orenda shpk, duke përfshirë bilancet, deklaratimet në ATK, librat financiar, dokumentet e arkivuara që kanë të bëjnë me pasqyrat e shpenzimeve të biznesit, dëshmit e investimeve, librat ndërtimor, kontratat me palët e treta, dëshmit e punëve të përfunduara, e dokumentet tjera të Shoqërisë Tregtare.

Në arsyetim të këtij vendimi gjykata e shkallës së parë referohet në dispozitat e nenit 297.1 të LPK-së, dhe faktit se kemi të bëjmë me Shoqërinë Tregtare, menaxhmenti dhe organet e së cilës kanë përgjegjësi ligjore që të menaxhojnë tërë dokumentacionin e Kompanisë dhe t,ua ofroj në shikim, inspektim fotokopim, aksionarëve të saj, sa herë që kërkohet një gjë e tillë prej tyre.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kundërpropozuesit se aktvendimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk specifikon se për cilën periudhë kohore e detyron të paditurin që të ofroj qasje në bilancë, deklarime në ATK, libra ndërtimor, kontrata me palët e treta, Nga dispozitivi pika II e Aktvendimit të atakuar, në mënyrë të qartë është urdhëruar që kjo masë e

sigurimit hyn në fuqi menjëher dhe mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm të gjykatës.

Sipas vlerësimit të Kolegjit të Dhomës së Shkallës së Dytë, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shqyrtimi i çështjes janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 297 par.1 pika (a) dhe (b), e të cilat i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të mund ti pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, ngase propozuesi ka bërë të besueshme dhe të pranueshme propozimin për gjykatën, andaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, si dhe ka arritur të bëjë të besueshme të drejtën subjektive dhe ekzistimin e rrezikut.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë propozuesit-aksionarit do ti pamundësohej qasje në dokumentet dhe arkivat e Shoqëris Tregtare Orenda shpk, që është përgjegjësi ligjore e menaxhmentit të Shoqëris Tregtare, në këtë rast e kundërshtarit të sigurimit të menaxhoj me dokumentet e kësaj Shoqërie Tregtare.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 194, 208 dhe nenit 209 pika (b) të LPK-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II nr.1473/22 datë 27.09.2022**

**Kryetari i Kolegjit – gjyqtari  
Krenar Berisha**